



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

RAPORTI I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS PËR ZGJEDHJE, RIZGJEDHJE -AVANCIM TË PUNONJËSVE SHKENCORË DHE TË HULUMTUESVE

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013, nenit 25, si dhe në bazë të neneve 32 dhe 37 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, nr.01/B, nr. 1740, të datës 11.06.2024, përkatësisht 28/24, nr. 49, të datës 11.06.2024 , Këshilli Drejtues i IPK-së ka shpallur konkursin për zgjedhjen e punonjësit në titullin “Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi”.

Detyra e vetme e komisionit është të shqyrtojë dokumentacionin dhe të hartojë raportin profesional. Më hartimin e raportit përfundon puna dhe përgjegjësia e komisionit. Komisioni për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së punonjësit në titullin “Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi” në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, në përbërje: Prof. dr. Kamber Kamberi (kryetar), Prof. ass. dr. Agron Gashi (anëtar), Prof. ass. dr. Muhamet Peci (anëtar). Komisioni, pasi e ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e kandidatit të paraqitur në konkurs, i propozon Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës vlerësimin profesional-shkencor për kandidatin në titullin “Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi”:

VLERËSIMI PROFESIONAL DHE SHKENCOR

Bazuar në dokumentacionin dhe dosjet e dorëzuara nga kandidati, komisioni vërteton se në konkursin e shpallur më datë 14.11.2024, në Faqen Zyrtare të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe në gazetën “Epoka e re”, për pozitën në titullin “Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi”, ka konkurruar një (1) kandidat: **Murteza Osdautaj**, nr. protokollit 03/24, më 26. 11. 2024.

Komisioni, pasi e verifikoi dokumentacionin e dorëzuar nga kandidati, ka konstatuar se ai i plotëson kushtet formale juridike për t'iu nënshtruar procedurave të përzgjedhjes për pozitën e “Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi”. Komisioni e ka shqyrtuar dosjen e kandidatit dhe, në bazë të kritereve të shpallura në konkurs, e konsultoi thirrjen shkencore, përvojën e punës, të arriturat profesionale shkencore, projektet e kandidatit për zhvillimin profesional e shkencor në Institutin Pedagogjik të Kosovës, por edhe jashtë tij. Komisioni i ka paraqitur të dhënat biografike dhe bibliografike për kandidatin që ka aplikuar, sipas datës 26.11.2024 dhe nr. të protokollit 03/24:

1. **Murteza Osdautaj** (1964) ka lindur në Isniq të Deçanit. Studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe (bachelor, magjistraturë dhe doktoratë) i ka kryer në Universitetin e Prishtinës. Një titull tjetër të magjistratit të shkencave e ka marrë në fushën e edukimit special në programin e përbashkët në mes të Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Juvaskulës (Finlandë). Ka kryer dy specializime dyvjeçare në akademinë e CISCO-s për rrjetat kompjuterike dhe në akademinë e “Microsoft”-it për aplikacionet kompjuterike. Një kohë ka punuar mësues, një kohë këshilltar pedagogjik, një kohë tjetër në Drejtorinë e Arsimit në Deçan. Sot punon në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, në pozitën e drejtorit të Departamentit të Shkencës dhe Teknologjisë. Osdautaj ka punuar gazetar në disa prej gazetave të cilat në vitet e nëntëdhjeta botoheshin në Kosovë. Pas vitit 2005 është angazhuar mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit të UP-së, të “Ukshin Hotit” dhe në programin e Avancimit të Kualifikimit të Mësimdhënësve. Edhe në kolegjin UBT dhe në AAB ka ligjëruar për shkrimin akademik dhe për edukimin special. Osdautaj ka qenë anëtar i grupeve punuese për hartimin e Programit Kombëtar të Shkencës, Strategjisë për Zhvillim dhe Hulumtime Shkencore të UP-së si dhe të draftit të ri të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Inovacion dhe Teknologji. Ka udhëhequr komisionin qeveritar për hartimin e ligjit të ri për Akademinë e Shkencave dhe Arteve. Vitin e fundit Osdautaj ka qenë bashkautor i tekstit të Strategjisë Ballkanike për Hulumtim dhe Inovacion si dhe të Strategjisë Kombëtare të Inovacionit. Ka marrë pjesë, me kumtesa, në 84 konferenca të niveleve të ndryshme shkencore organizuar jashtë dhe brenda Kosovës. Ishte anëtar i Këshillit Shkencor të MASHT-it dhe i Këshillit të Librit në MKRS. Veprat e tij letrare janë shpërblyer me disa çmime në konkurset letrare të shpallura në Kosovë, kurse për menaxhim dhe mësimdhënie i janë dhënë disa mirënjohje nga agjenci dhe institucione arsimore dhe shkencore. Poezia, studimet në fushën e letërsisë dhe hulumtimet në fushën e arsimit special janë veprimtaritë kryesore të interesimit të Osdautajt, i cili deri më tash ka botuar disa libra artistikë, studimorë e veçanërisht hulumtime në fushë të mësimdhënies dhe mësimnxënies në Kosovë.

Shënimet përmbledhëse për kandidatët e paraqitur për pozitën: Drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës, në bazë të konkursit nr. 189/02, datë 29.08.2024

| 1. | Emri dhe mbiemri | Biografia (CV) | Grada dhe thirrja shkencore | Moshë (datëlindja) | Përvoja në udhëheqje | Përvoja kërkimore -- shkencore | | | Projekti për zhvillimin e veprimtarisë së IPK-së për periudhën 4-vjeçare | Njohja e gjuhës angleze | Dëshmi se kandidati nuk është i dënuar |
|----|-------------------------|----------------|--|--------------------|----------------------|--|--------------------------------------|-----------------------------|--|-------------------------|--|
| | | | | | | Publikimet shkencore: Artikuj në revista të indeksuara | Kumtesat në konferenca ndërkombëtare | Monograf i, libra të botuar | | | |
| 1 | Murteza Osdautaj | PO | Master – Fusha e Filologjisë Doktoratura - Fusha e Filologjisë | 15.04.1964 | 32 vjet | 1 punim | 84 kumtesa | 5 | 4 projekte të përfunduara, 2 projekte në realizim e sipër | 4- sh. mirë. | PO |

Bazuar në të arriturat e punës profesionale dhe shkencore, përgatitjen adekuate për pozitën e kërkuar në konkurs, publikimet shkencore të botuara në revistat shkencore relevante, pjesëmarrjen në aktivitete profesionale, përvojën në hulumtime shkencore me theks në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, përvojën në Arsimin e Lartë, pjesëmarrjen në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, Komisioni recensues propozon që kandidati, **Dr. sc. Murteza Osdautaj**, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në konkurs, për pozitën “Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi”.

PËRFUNDIM

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013, nenit 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, Rregullores nr. 55/24, të datës 12.09.2024, për procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencorë dhe Hulumtuesve në IPK, Ligjit të punës nr. 03/L212, po ashtu bazuar edhe në të arriturat profesionale dhe shkencore, Komisioni recensues për zgjedhjen e punonjësit “Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi” ka kënaqësinë t’ia propozojë Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës kandidatin **Dr. sc. Murteza Osdautaj**, i cili i plotëson të gjitha kushtet për thirrjen e kërkuar sipas konkursit në fjalë.

Prishtinë, 9. 12. 2024

Komisioni recensues për zgjedhjen punonjësit në titullin “Bashkëpunëtor shkencor për fushën kurrikulare gjuhët dhe komunikimi” në IPK:

1. Prof. dr. Kamber Kamberi (kryetar)
2. Prof. ass. dr. Agron Gashi (anëtar)
3. Prof. ass. dr. Muhamet Peci (anëtar)

